




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KONTRATË

PËR

DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS KOMUNALE -
PARKINGUT

Palët kontraktuese

1. **Komuna e Gjakovës**, të cilën e përfaqëson Ardian Gjini, Kryetar i Komunës, dhënësi i pronës komunale – parkingu në rrugën “UÇK” e evidentuar me numër kadastral të ngastrës: P-70705029-00468-24, në sipërfaqe të përgjithshme prej 3185m², (në vazhdim të tekstit: Komuna) dhe
2. **Porta Homes SH.P.K.**, të cilën e përfaqëson Adnan Krasniqi, me numër personal 1170267571, me numër të biznesit 811288522 nga Prishtina, shfrytëzues i pronës komunale (në vazhdim të tekstit: shfrytëzuesi).

Neni 1
Baza Juridike

Baza juridike për lidhjen e kësaj kontrate është e përcaktuar në dispozitat e nenit 5, 6, 8 dhe 14 pika 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Vendimin 01 Nr.011/01-3512 të datës 07.02.2022, vendimin 01Nr.011/01-8188 të datës 30.03.2022 të miratuar nga Kuvendi Komunal për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, Njoftimit Publik 01-463/01-11080 të datës 04.05.2022, për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, Rekomandimit të Komisionit Vlerësues të datës: 14.07.2022.

Neni 2
Objekti i Kontratës

Objekt i kësaj kontrate është dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga Komuna dhe marrja në shfrytëzim afatshkurtër nga Shfrytëzuesi, pronën komunale – parkingun në rrugën “UÇK” e evidentuar me numër kadastral të ngastrës: P-70705029-00468-24, në sipërfaqe të përgjithshme prej 3185m².

Neni 3

Kohëzgjatja e Shfrytëzimit

1. Komuna dhe Shfrytëzuesi janë pajtuar që prona komunale - parkingu sipas në nenin 2 të kësaj kontrate të merret në shfrytëzim në kohëzgjatje prej një (1) viti, duke filluar nga data **19.07.2022 deri më datën 19.07.2023**.

2. Afati i shfrytëzimit nuk mund të zgjatet pa procedurë të re të njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale.

Neni 4

Vlera e Kompensimit për Shfrytëzimin

Palët janë pajtuar që për shfrytëzimin e pronës komunale – parkingu, që vlera e kompensimit për periudhën e cekur në nenin 3 të kësaj kontrate, për periudhën mujore është pesëmijë e treqind (5,300.00) € në muaj.

Neni 5

Mënyra dhe Afatet e Pagesës së Kompensimit

1. Palë janë pajtuar që pagesa e shumës së kompensimit nga shfrytëzuesi, për shfrytëzimin e pronës komunale – parkingut e përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj kontrate të bëhet në fillim të çdo muaji, por jo më larg se deri më datën 05 të muajit.
2. Shfrytëzuesi, pagesën e qirasë e bën në ditë pune në xhirollogari të Komunës së Gjakovës me destinim: pagesa e kompensimit për shfrytëzimin e pronës komunale – parkingu.

Neni 6

Dorëzimi i Pronës Komunale - parkingut në Shfrytëzim

1. Komuna dhe shfrytëzuesi janë pajtuar që dorëzim-pranimi i pronës komunale - parkingut të bëhet më së largu 10 ditë nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate, nga Komisioni i përcaktuar nga Komuna me procesverbal.
2. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në këtë kontratë për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës.

Neni 7

Destimi i Shfrytëzimit

Prona komunale – parkingu sipas nenin 2 të kësaj kontrate, ka destinimin për parking, nuk mund ti ndryshohet destinimi, po ashtu nuk mund t'ia jep pronën komunale – parkingun në shfrytëzim me nën-qira personave tjerë fizikë dhe juridik, dhe nuk mund të jetë objekt i pengut (hipotekës) apo çfarëdo barre tjetër në raport me personat e tretë.

Neni 8

Obligimet e Komunës

1. Komuna në pajtim me këtë kontratë është e obliguar që të i mundësojë pa pengesa shfrytëzuesit, shfrytëzimin e pronës komunale - parkingun.
2. Komuna obligohet që të evidentojë shënimet përkatëse në librat e pronësisë për shfrytëzimin e pronës komunale - parkingun.

Neni 9

Obligimet e Shfrytëzuesit

1. Shfrytëzuesi i pronës komunale - parkingut në pajtim me këtë kontratë nuk i lejohet ushtrimi i veprimtarive tjera përveç destinimit të caktuar si parking.
2. Shfrytëzuesi obligohet që veturat zyrtare të institucioneve komunale, të lirohen nga pagesa për shfrytëzimin e parkingut.
3. Shfrytëzuesi i pronës komunale obligohet që të vendosë pajisje të komunikacionit për parking sipas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike – Sektori i Komunikacionit.
4. Shfrytëzuesi i pronës obligohet që të rezervojë dhe të vendosë shenjat e komunikacionit për dy vend parkingje për veturat e personave me nevoja të veçanta, si dhe të lirojë nga pagesa për këto dy vend parkingje.
5. Komuna për interes të përgjithshëm në zbatim të projekteve në prona publike rezervon të drejtën të realizojë punime pa u penguar nga shfrytëzuesi.
6. Çmimet për vend parking për vetura, nuk mund të jenë më të larta për orë ose muaj qëndrimi, se sa janë të planifikuara në Rregulloren për Taksa Komunale.
7. Shfrytëzuesi gjatë shfrytëzimit të pronës komunale – parkingun, duhet të sigurojë qasje në hyrje daljet tek objektet publike, “Pallati i Kulturës” dhe “Biblioteka e Qytetit” pa u penguar nga veturat.
8. Shfrytëzuesi është i obliguar që t’i kryejë të gjitha shërbimet e komunalive si ujë, rrymë mbeturina etj, nga dita e marrjes në shfrytëzim.

Neni 10

Inspektimi

Komuna ka të drejtën të kontrollojë dhe të inspektojë pronën komunale - parkingun në çdo kohë, pa pasur kundërshtim nga shfrytëzuesi qiramarrësi. Inspektimi ka për qëllim për të konstatuar gjendjen momentale të pronës komunale - parkingu gjatë kohës së shfrytëzimit nga ana e qiramarrësit.

Neni 11

Shkëputja e Kontratës me Marrëveshje

1. Palët kontraktuese në çdo kohë me marrëveshje mund të bëjnë shkëputjen e kësaj kontrate.
2. Lidhur me shkëputjen e kontratës, palët hartojnë dokument përkatës me shkrim duke zbatuar në tërësi nenin 9 të kësaj kontrate.
3. Para nënshkrimit të aktit mbi shkëputjen me marrëveshje të kontratës, palët rregullojnë në pajtim me ligjin, çështjet lidhur me obligimet e mbetura.

Neni 12
Shkëputja e Njëanshme e Kontratës nga Komuna

1. Komuna rezervon të drejtën për shkëputje të kësaj kontrate në këto raste:
 - 1.1. Kur Shfrytëzuesi i pronës komunale - parkingut dështon të paguajë cilindo prej kësteve në shumën dhe afatin e përcaktuar në nenin 5 të kësaj kontrate;
 - 1.2. Kur shfrytëzuesi i pronës komunale nuk respekton njërin nga pikat e kësaj kontrate, Komuna me vendim të veçantë do të shkëpusë kontratën.
 - 1.3. Nëse me dëshmi të mbikëqyrjes inspektive konstatohet se ka bërë ndërrime të strukturës së parkingut dhe ndërtime të reja pa marrë pëlqim sipas nenit 9 të kësaj kontrate.

Neni 13
Shkëputja e Njëanshme e Kontratës nga Shfrytëzuesi

1. Shfrytëzuesi do të shkëputë kontratën në mënyrë të njëanshme nëse Komuna nuk përmbushë obligimet e përcaktuara në nenin 8 të kësaj kontrate.
2. Me heqjen dorë të shfrytëzuesit, nga shfrytëzimi i mëtejshëm i pronës komunale - parkingut duke njoftuar me shkrim për këtë Komunën në afat prej 3 muajve para kohës për të cilën qiramarrësi nuk dëshiron të shfrytëzojë parkingun.

Neni 14
Zbatimi i kontratës

Për zbatimin në tërësi të kësaj kontrate do të kujdeset Kryetari i Komunës, duke e autorizuar Komisionin përgjegjës me vendim të veçantë.

Hyrja në Fuqi

1. Kjo kontratë është përpiluar në katër (4) ekzemplarë autentik dhe përbën katër (4) faqe e cila pas leximit nga kontraktuesit është nënshkruar pa vërejtje.
2. Me kopje të kësaj kontrate përveç Qiradhënësit dhe Qiramarrësit do të njoftohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Punë Inspektuese dhe Drejtoria për Gjeodezi, kadastër dhe Prone.
3. Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

P A L E T


Komuna e Gjakovës

Ardian Gjini


Prishtinë
Porta Homes SH.P.K
PORTA HOMES

SH.P.K
Adnan Krasniqi